

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-qershor 2020
- Zhvillimet e Tregut të Titujve të Qeverisë, janar-qershor 2020

Zhvillime të tjera

- AMF udhëzon subjektet nën mbikëqyrje për pritshmëritë rregullatore për situatën e Covid-19
- Zhvillohet mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar
- Lançohet platforma e publikimit të të dhënave ditore të kuotave të fondeve të investimeve dhe pensioneve private vullnetare
- AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren mbi licencimin, bazuar në ligjin “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”
- Autoriteti kroat mbështet AMF për përafrimin me standardet e BE në mbikëqyrjen e tregjeve

Botime Profesionale

Informacione Ndërkombëtare

- Çeki
- Serbi
- Slloveni
- Turqi
- IAIS

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv raporton në Kuvendin e Shqipërisë

Drejtimet kryesore të veprimtarisë së AMF-së gjatë këtij viti do të jenë menaxhimi i situatës dhe ruajtja e qëndrueshmërisë së tregjeve në mbikëqyrje, plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullator, arritja e standardeve të larta të mbikëqyrjes, digjitalizimi dhe modernizimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, si edhe hartimi i strategjisë së re për mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit



23 korrik 2020 – Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Mete, gjatë raportimit në Kuvendin e Shqipërisë

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete prezantoi më 23 korrik, në seancë plenare në Kuvendin e Shqipërisë, raportin mbi veprimtarinë e Autoritetit gjatë vitit 2019. Z. Mete u ndal në zhvillimet kryesore të vitit të kaluar, si edhe përmendi disa nga drejtimet më të rëndësishme për vitin në vazhdim, duke marrë parasysh efektet e pandemisë në tregjet nën mbikëqyrje. Duke iu referuar këtyre ndikimeve në ekonomi dhe në sektorin financiar, Z. Mete theksoi rëndësinë që ka për Autoritetin dhe për operatorët e tregjeve nën mbikëqyrje, marrja e masave për përballimin sa më të kujdesshëm të tyre.

“Autoriteti u ka kërkuar të gjithë operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje që të përditësojnë dhe të kenë funksionale plane të vazhdimësisë së veprimtarisë dhe planet e përballimit të krizave, ku të detajohen të gjithë elementët teknikë, logjistikë, njerëzorë dhe financiarë për përballimin e efekteve të mundshme. Gjithashtu, në linjë me rekomandimet e autoriteteve rregullatore evropiane, ju është kërkuar operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje të vlerësojnë efektet e pandemisë për konsumatorët, por edhe për vetë shoqëritë,” theksoi z. Mete.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv bëri me dije se AMF ka marrë vendim që deri në fund të vitit të mos ketë asnjë shpërndarje fitimi nga subjektet nën mbikëqyrje, në mënyrë që kapitalet të mbahen në sistem, duke vlerësuar këtë si një nga mënyrat efektive për të rikuperuar luhatje të mundshme të treguesve.

Z. Mete informoi deputetët e Kuvendit të Shqipërisë për ecurinë e tregjeve nën mbikëqyrje gjatë vitit 2019, ku dy tërmetet ishin ngjarjet madhore që shënjuan vitin e kaluar tregun e sigurimeve.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit gjatë këtij viti do të jenë menaxhimi i situatës dhe ruajtja e qëndrueshmërisë së tregjeve të mbikëqyrura, plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullator, arritja e standardeve të larta të mbikëqyrjes, digjitalizimi dhe modernizimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, si edhe hartimi i strategjisë së re për mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit.

Raportimi në seancën plenare në Kuvend, erdhi pas prezantimit të bërë më 14 korrik, në Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, të aktivitetit vjetor të AMF-së. <https://amf.gov.al/news.asp?id=32532>

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-qershor 2020


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit në periudhën janar-qershor 2020 arritën vlerën mbi 7,544 milionë lekë, ose 6.66% më pak se në periudhën janar-qershor 2019. Gjatë periudhës janar-qershor 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 434,968 me një ulje prej 26.45% krahasuar me periudhën janar-qershor 2019.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.49% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.49%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.62% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.38% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-qershor 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,081 milionë lekë, ose 46.75% më shumë se në periudhën janar-qershor 2019.

Gjatë periudhës janar-qershor 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,081 milionë lekë, ose 46.75% më shumë se gjatë janar-qershor 2019.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar - Qershor 2020




Zhvillimet e Tregut të Titujve të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2020

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2020, u dominua në masën 67.1% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 32.9% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 89.09% e të gjitha transaksioneve të tregut të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat mbi tregun e titujve të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2020, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim”, përkatësisht me 46.02% dhe 38.43% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun e titujve të Qeverisë, për periudhën janar-qershor 2020 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.54% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Tregu i Titujve të Qeverisë janar-qershor 2020 (Në %)



Pjesëmarrja në tregun e titujve të Qeverisë, për periudhën janar-qershor 2020 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.54% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-qershor 2020, ka pasur një ulje prej 1,821 milionë lekë ose 50.97% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 6.44%.

Gjatë periudhës janar-qershor 2020, transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” ka pasur një rritje prej 78 milionë lekë ose 5.99%, ndërkohë që pati një ulje në numrin e transaksioneve në masën 37.38%, krahasuar me periudhën janar-qershor 2019.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një ulje në vlerë absolute me rreth 1,743 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-qershor 2019.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF udhëzon subjektet nën mbikëqyrje për pritshmëritë rregullore për situatën e Covid-19



Masat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ndaj Covid-19

Efektet e pandemisë vijojnë të jenë të ndjeshme në ekonominë e vendit dhe në veprimtarinë e sektorit financiar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka qenë në monitorim të vazhdueshëm të situatës dhe në këtë kuadër ka marrë një sërë masash dhe ka dhënë disa rekomandime.

Autoriteti u ka kërkuar të gjithë operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje që të përditësojnë dhe të kenë funksionale plane të vazhdimësisë së veprimtarisë dhe planet e përballimit të krizave, si edhe të vlerësojnë efektet e pandemisë të qytetarët, por edhe vetë shoqëritë.

- + Masa rregullore dhe rekomandime
- + Bashkëpunimi ndër-institucional
- + Institucioni i AMF

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar më 29 korrik 2020 udhëzimin “Mbi pritshmëritë rregullore ndaj subjekteve nën mbikëqyrje, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19”.

Autoriteti po monitoron në vazhdimësi tregjet nën mbikëqyrje dhe, në linjë me rekomandimet e rregullatorëve të tjerë homologë, ka kërkuar marrjen e masave në shoqëritë dhe kujdes të shtuar.

Në faqen *online* të AMF-së gjendet një seksion për masat dhe rekomandimet në lidhje me pandeminë Covid-19.

<https://amf.gov.al/covid.asp>

Zhvillohet mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete mori pjesë më 21 korrik 2020 në mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Mbledhja e zhvilluar online u drejtua nga Ministrija e Financave dhe Ekonomisë dhe në të morën pjesë edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë (BSH), Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), si edhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete, informoi të pranishmit në lidhje me zhvillimet në tregjet nën mbikëqyrje, efektet që solli pandemia COVID-19 dhe masat e marra nga Autoriteti për të amortizuar rreziqet dhe forcuar rezistencën e sistemit financiar.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete, informoi të pranishmit në lidhje me zhvillimet në tregjet nën mbikëqyrje, efektet që solli pandemia COVID-19 dhe masat e marra nga Autoriteti për të amortizuar rreziqet dhe forcuar rezistencën e sistemit financiar.

Lançohet platforma e publikimit të të dhënave ditore të kuotave të fondeve të investimeve dhe pensioneve private vullnetare



20 korrik 2020 - Lançimi i platformës së publikimit të të dhënave ditore të kuotave të fondeve të investimeve dhe pensioneve private vullnetare

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi se nisma të tilla rrisin transparencën dhe informimin, që janë thelbësore për natyrën e tregjeve të kapitalit, por edhe në fokusin kryesor të punës së AMF-së.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete mori pjesë në lançimin e platformës së publikimit të të dhënave ditore të kuotave të investimeve dhe pensioneve private vullnetare.

Në fjalën e tij, Z. Mete vuri në dukje se nisma të tilla shtojnë transparencën dhe informimin, që janë thelbësore për natyrën e tregjeve të kapitalit, por edhe fokus kryesor i punës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv u shpreh se infrastruktura e Bursës është tashmë e kompletuar nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, përmes licencimit të “Regjistrimit Shqiptar të Titujve” për klerimin dhe shlyerjen e titujve korporativë.

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren mbi licencimin, bazuar në ligjin “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, ka hartuar projektregulloren “Mbi licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”.

Projektregullorja dhe shtojcat përkatëse publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik,
https://amf.gov.al/pdf/fokus/Projekt-Rregullore-AMF_1.pdf

Agjencia kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare mbështet AMF për përafrimin me standardet e BE në mbikëqyrjen e tregjeve



3 korrik 2020 – Takimi online me Presidentin e Agjencisë Kroate të Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare

Në takim u ra dakord për finalizimin e një Memorandumi mes AMF dhe HANFA, i cili përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi në të ardhmen.

Përafrimi me praktikat mbikëqyrëse të vendeve të Bashkimit Evropian ishte në fokusin e takimit online të zhvilluar mes Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF, z. Ervin Mete dhe Presidentit të Agjencisë Kroate të Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare (HANFA), z. Ante Zigman. Në takim u përcaktuan linjat kryesore të bashkëpunimit, ku eksperiencia kroate do t'i shërbente Autoritetit. Në këtë drejtim, HANFA pritet të asistojë AMF në kuadër të mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve dhe mbikëqyrjes së konsoliduar të tregjeve, përgatitjes për regjimin Solvency II, digjitalizimin dhe përmirësimin e sistemeve të raportimit dhe analizës, edukimin financiar, etj.

Z. Mete e falëndëroi z. Zigman për gadishmërinë dhe frymën bashkëpunuese të shfaqur nga Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare. Nga ana e tij, Presidenti i HANFA-s theksoi mundësitë e asistencës në drejtim të Autoritetit edhe nëpërmjet projekteve të Bashkimit Evropian.

Në takim u ra dakord për finalizimin e një Memorandumi mes AMF dhe HANFA, i cili përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi në të ardhmen.

Journal of Pension Economics & Finance



<https://www.cambridge.org/core/journals/journal-of-pension-economics-and-finance/article/on-the-effect-of-financial-education-on-financial-literacy-evidence-from-a-sample-of-college-students/A4CFE6744550C5A640DC5730A73C087D>

Mbi efektin e edukimit financiar në arsimimin financiar: të dhëna nga një anketim me studentë të kolegjeve

(On the effect of financial education on financial literacy: evidence from a sample of college students)

Studimi është bazuar në një kampion të përbërë nga një grup studentësh të universiteteve. Analiza e të dhënave të marra gjatë këtij studimi tregon se si një ndërhyrje në shkallë të vogël, ka efekt të rëndësishëm, si nga pikëpamja statistikore ashtu edhe ekonomike, në vlerësimin subjektiv dhe objektiv të njohurive financiare. Studimi tregon se me ndërhyrjen për të rritur edukimin financiar, rritet më shumë vetëvlerësimi për këto njohuri financiare. Në realizimin e studimit është kryer matja e njohurive financiare para dhe pas një kursi *online*, i cili administrohet përmes një platforme *online* për njohuritë financiare.

Financial Times

<https://www.ft.com/content/61ed7c3d-d763-44c1-ad62-ca7eaeac0634>

G20 nën presion për zhvillimin e një plani botëror për zbutjen e rënies ekonomike

Ministrat dhe drejtuesit e bankave qendrore do të takohen për të diskutuar rreth rregullimit të ekonomisë.

(G20 under pressure to boost global recession mitigation plan. Ministers and central bank governors to meet to discuss economic rescue efforts)

The Economist

<https://www.economist.com/finance-and-economics/2020/07/11/the-pandemic-revives-ultra-safe-european-bonds>

Situata e pandemisë risjell në vëmendje *European Bonds*. Së shpejti, Komisioni Evropian mund të bëhet një nga pjesëmarrësit e mëdhenj në tregun e kapitalit.

(The pandemic revives ultra-safe European bonds - The European Commission could soon become a big player in capital markets)





The International Organisation of Pension Supervisors (IOPS) is an independent international body representing institutions involved in the supervision of private pension arrangements. [Read more...](#)

News and Events

IOPS Members measures taken to address the COVID-19 crisis

9-11 November 2020: Virtual IOPS Committee Meetings and AGM & (TBC) OECD/IOPS Global Forum on private pensions, Yerevan, Armenia.

15-17 June 2020: IOPS Virtual Committee Meetings jointly with the OECD WPPP followed by the IPRA Virtual Conference on Pension challenges and opportunities, 26 June 2020.

26 May 2020: IOPS releases its Statement on pension supervisory actions to mitigate the consequences of the Covid-19 crisis

Find

- > Organisational Structure
- > IOPS Members and Observers
- > Programme of Work for 2019-2020
- > IOPS Strategy 2019-2024 (pdf)
- > Annual Reports
- > IOPS Principles
- > Research by jurisdiction/territory of pension system profiles
- > How to become a Member

[Working Papers on Effective Pension Supervision](#)

[IOPS Guidelines and Good Practices](#)

[IOPS Toolkit for Risk-based Supervision](#)

IOPS

IOPS – Materiale Diskutimi lidhur me mbikëqyrjen efektive të pensioneve. (*IOPS -Working Papers on Effective Pensions Supervision, No.34*)

Ndërkohë që përqindja e të ardhurave të siguruara nga pensionet private bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, cilësia dhe efektiviteti i mbikëqyrjes së tyre bëhet gjithnjë e më thelbësor. Seria e publikimeve si Materiale Diskutimi të IOPS ka filluar në gusht 2007. Këto materiale nënvizojnë një sërë sfidash me të cilat duhet të përballësh kur punon për zhvillimin e sistemeve mbikëqyrëse të pensioneve në vend. Materialet e Diskutimit shqyrtojnë natyrën dhe efektivitetin e sistemeve të reja të mbikëqyrjes së pensioneve, duke dhënë shembuj, përvoja dhe mësimet të nxjerra në dobi të anëtarëve të IOPS dhe komunitetit më të gjerë.

Materialet e Diskutimit të IOPS nuk janë botime zyrtare. Ato paraqesin rezultate dhe analiza paraprake për të inkurajuar diskutimin dhe komentet lidhur me tematikat e ndryshme që prezantohen në secilin nga Materialet e Diskutimit. Çdo përdorim ose citim i këtyre Materialeve të Diskutimit duhet të marrë parasysh këtë karakter të përkohshëm të tyre. Gjetjet dhe konkluzionet e punimeve pasqyrojnë pikëpamjet e autorëve dhe mund të mos përfaqësojnë mendimet e anëtarësisë në tërësi të IOPS.

Abstrakt

Ky publikim hedh një vështrim mbi strukturën, formën dhe mbikëqyrjen e pensioneve bazuar në anketimin e 26 juridiksioneve. Paraprakisht, parashikimet e pensioneve në juridiksionet e anketuara të IOPS, mblidhen nga fondet e pensioneve dhe mbikëqyrësit në formën e përlogaritjeve *online*. Ato hartohen nga subjektet e mbikëqyrura, autoritetet mbikëqyrëse ose institucionet e tjera qeveritare, ose edhe nëpërmjet komunikimeve të rregullta me subjektet e pensioneve, etj.

Punimi ofron gjithashtu një përmbledhje të variabëlve kryesore të përdorura gjatë ndërtimit të parashikimeve për pensionet. Punimi zbulon se parashikimet në juridiksionet e anketuara kanë tendencë të jenë përcaktuese, të individualizuara dhe të bazuara në një skenar. Në pjesën më të madhe të juridiksioneve, parashikimet tregojnë bashkërendimin e të dy formave, si në formën e aseteve të akumuluar për të ardhmen e pensioneve, ashtu edhe përfitimet pensionale, të shprehura në kushtet e sotme. Shumica e juridiksioneve tregojnë përfitime të pritura nga një kolonë e vetme (*single pillar*). Metodologjia e përdorur për parashikimet si edhe supozimet kryesore të ngritura, janë hartuar nga fondet e pensioneve dhe bordet e tyre, nga mbikëqyrësit e pensioneve ose nga institucionet qeveritare.

Mbikëqyrësit e pensioneve përballen me sfidat për të siguruar cilësinë e parashikimeve, për gjetjen e metodave të duhura për prezantimin e rezultateve, si edhe për çështjet e standardizimit, etj.

Raporti propozon rekomandime në fushën e hartimit dhe mbikëqyrjes së parashikimeve për pensionet.



IOPS Working Papers on Effective Pensions Supervision, No.34

DESIGN AND SUPERVISION OF PENSION PROJECTIONS IN 26 JURISDICTIONS

Doriant Shtriko
December 2013

Çeki

www.xprimm.com

Shifrat e publikuara nga Banka Kombëtare e Çekisë, për tremujorin e parë të vitit 2020, tregojnë se industria e sigurimeve në vend arriti në rreth 45.39 miliardë CZK (rreth 1.66 miliardë EUR), me rritje prej 8.62% krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar.

Vlen të theksohet se, tregu i sigurimeve të Jetës, i prekur nga pandemia e COVID-19, pati rënie të vëllimit të primeve të shkruara bruto (duke përfshirë edhe risigurimin) me më shumë se 7% në bazë vjetore, duke arritur në 53.41 miliardë CZK. Ndërsa në produktet dhe grupet e tjera të sigurimeve, linjat e biznesit si mbrojtja mjekësore dhe e të ardhurave raportuan ritme të rritjes me tre shifra. Nga ana tjetër, produkte sigurimesh si ndihma për udhëtime apo sigurime të tjera të transportit raportuan ecuri me norma negative.

Serbi

www.xprimm.com

Të dhënat e Bankës Qendrore të Serbisë tregojnë se në tremujorin e parë të vitit 2020, vëllimi i primeve të shkruara bruto të kompanive të sigurimeve serbe u rrit me 8.52%, duke arritur në 26.94 miliardë RSD ose rreth 229 milion EUR.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për kompanitë e sigurimeve të Jetës u rrit me 10.76% duke arritur në 6.25 miliardë RSD, ndërsa pagesa (dëmshpërblimet dhe maturimet) u rritën 11.23% duke arritur në 3.49 miliardë RSD.

Gjithashtu, vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës arriti në 20.69 miliardë RSD, duke u rritur me 7.86% e llogaritur mbi baza vjetore. Ndërkohë që dëmet e paguara nga siguruesit u rritën me 37% në bazë vjetore, duke arritur në 12.62 miliardë RSD.

Sloveni

www.xprimm.com

Sipas statistikave të publikuara nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve, tregu i sigurimeve në vend arriti në 714 milion EUR në fund të Marsit 2020, duke shënuar kështu një rritje prej 6.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Të dyja segmentet e tregut, si sigurimi i Jetës ashtu edhe sigurimi i Jo-Jetës patën norma pozitive rritjeje, përkatësisht me 5.58% dhe 6.44% krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Kështu volumi i primeve të shkuara bruto arriti në 198 milionë EUR në sigurimin e Jetës dhe 517 milionë EUR në segmentin e sigurimeve të Jo-Jetës.

Statistikat e publikuara tregojnë se në tremujorin e parë të vitit 2020 vlera e përgjithshme e dëmeve të paguara ishte 441 milionë EUR. Nga shifra totale, rreth 158 milionë EUR ishin dëmshpërblime për policat e sigurimit të Jetës, 130 milionë EUR ishin pagesa në lidhje me kontratat e sigurimit shëndetësor, 97 milionë EUR ishin pagesa për sigurimet motorike, dhe rreth 56 milionë EUR ishin dëmshpërblime të tjera në sigurimet e Jo-Jetës.

Turqi

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, TSB, gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, sektori turk i sigurimeve arriti një vëllim të primeve të shkruara bruto me 21.83 miliardë TRY (3.03 miliardë EUR). Kjo shifër paraqet një rritje prej 24.79% në krahasim me periudhën të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, TSB, gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, sektori turk i sigurimeve arriti një vëllim të primeve të shkruara bruto me 21.83 miliardë TRY (3.03 miliardë EUR). Kjo shifër paraqet një rritje prej 24.79% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në tre muajt e parë të vitit 2020, vëllimi i primeve të shkruara bruto, për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës arriti në 17.69 miliardë TRY, ndërsa sigurimi i Jetës arriti në 4.13 miliardë TRY. Sipas statistikave të tremujorit të parë të vitit 2020, duke krahasuar vëllimin e primeve të shkruara bruto, klasat më të mëdha të sigurimit të Jo-Jetës në biznes ishin ato për sigurimin e pasurive, me mbi 5 miliardë TRY primë, e ndjekur nga MTPL me rreth 4.89 miliardë TRY prime dhe shëndetësia me 3.29 miliardë TRY.

Për sa i përket pagesave të dëmeve, sigurimet e Jo-Jetës paguan rreth 7.18 miliardë TRY dëme duke zënë rreth 85.25% të totalit të dëmeve të paguara. Sigurimi i Jetës pagoi dëmshpërblime me vlerë 1.24 miliardë TRY.

IAIS

<https://www.iaisweb.org/news/press-release-iais-executive-committee-confirms-continued-focus-on-addressing-the-impact-of-covid-19-on-the-global-insurance-sector-while-advancing-key-iais-projects>



Komiteti Ekzekutiv i IAIS konfirmon vëmendjen e shtuar dhe fokusimin tek adresimi i ndikimit të Covid-19 në sektorin global të sigurimeve. Ndërkohë, Komiteti Ekzekutiv theksoi vijimësinë me projektet kryesore të IAIS.

Gjatë qershorit 2020, Komiteti Ekzekutiv i IAIS (ExCo) zhvilloi një seri *webcast-e* për të diskutuar një gamë të gjerë të çështjeve, të politikave, ecurinë e projekteve kryesore dhe rishikimin e programit të punës së vazhdueshme të IAIS në kushtet e pandemisë Covid-19.

Pandemia e Covid-19 ka nënvizuar rëndësinë e një sektori të sigurimit elastik, për të siguruar nga njëra anë mbështetjen financiare, duke zvogëluar pasigurinë për njerëzit dhe bizneset në nevojë, dhe gjithashtu edhe duke e bërë këtë sektor një investitor të rëndësishëm institucional, duke ndihmuar në financimin e rimëkëmbjes ekonomike.

Siguruesit dhe autoritetet mbikëqyrëse qëndrojnë vigjilentë ndaj rreziqeve dhe dobësive që rrjedhin nga pandemia, duke u fokusuar në ruajtjen e elasticitetit financiar dhe operacional të sektorit. Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) kohët e fundit zhvilloi në mënyrë virtuale tryezën e saj të Komitetit Ekzekutiv, duke diskutuar një gamë të gjerë të çështjeve, të politikave, përparimin e projekteve kryesore dhe përshtatjen e programit të punës në vazhdim të IAIS-it, nën kushtet e pandemisë Covid.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al